



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr- 111-67664

ME DATE 26.09.2019

SH PALLJE P U B L I K E

Per angazhimin e punëtorëve me kontratë për punë dhe detyra specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Komuna e Suharekës duke u bazuar në nenin 10 alinea 2 pika 2.3 te ligjit të punës Nr.03/L-212 si dhe bazuar në kërkesen e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë, përmes Kontrates për punë dhe detyra specifike kërkon angazhimin e punëtorëve për kryerjen e punëve për nevojat e kësaj Drejtorie.

I.Drejtoria për Administratë: Kërkon shtatë (7) mirëmbajtës (pastrues) të objekteve të Komunës.

Kohëzgjatja e kontratës deri ne zgjedhjen e operatorit ekonomik nga zyra e Prokurimit.

Paga: 250 Euro Bruto

Kualifikimi : Shkolla fillore

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1 Bën pastrimin e nevojshëm të gjitha hapësirave në objektet e Komunës.

2: Kujdeset për pastrimin e inventarit.

3: Kujdeset për vendosjen e pajisjes dhe oredive në vendin e duhur

4: Kryen punë tjera sipas nevojës

Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkohet:

- Të jete person me integritet te larte personal dhe moral;
- Aftësi të mira komunikimi ;
- Njohuri të mira të punës;

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet te paraqesin një biografi profesionale (CV), certifikaten qe ndaj tij-saj nuk jane duke u zhvilluar hetimet,kopja e letërnjoftimit kopjet e dokumentacionit për kualifikimin. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.

Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Suharekës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata te cilët nuk hyjnë ne perzgjedhje nuk do te kontaktohen.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen.

Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Suharekës ofron mundësi te barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.



Kryetari i Komunës

Bali Muharemaj